

BIBLIOTEKA

814-1
A37

DRITËRO AGOLLI

P O E M Ë
P Ë R B A B A N Ë
D H E P Ë R V E T E N



TIRANË, 1962

891.983-1

133 2127

177 2127

891.983-1

A 37

DRITËRO AGOLLI

5
BIBLIOTEKA E SHTETIT
D. DROKASIT

~~32200~~

11 280

P O E M Ë

PËR BABANË

DHE

PËR VETEN

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1962

POEMË PËR BABANË DHE PËR VETEN

*... Dhe nga pasardhësit e tij
ai kërkonte rregull.*

R. Berns.

I.

Punonte tokën ati im
Në djell' e shi e mjergull
«Dhe nga pasardhësit e tij
Ai kërkonte rregull».

Nuk qe mësonjës plaku im,
Po mua më mësonte;
Ai nga unë nat' për nat'
Mësimin e kërkonte.

Ma dha në dorë q'atëherë
Parmëndën dhe hostenë,
E fshiu djersën edhe tha:
«Tani këtheje dhenë!»

Po kur i thashë atit tim
Një ditë nënë ftua:
«Përse kaq shpejt ti m'i mësove
Të gjitha punët mua?».

E thithi tymin e çibukut
Dhe foli me ngadalë:
— «Që mos ta hajë qeni shkopin,
O biri im, o djalë!»

II.


Po ishin kohra të vështira
Ahere mbi Atdhe,
Në vatër hasmi na kish hyrë
Dhe qielli ish me re.

... Babaj një ditë nënë hatull
S'e dij se ç'po kërkonte
Dhe dy-tre gurë të mëdhenj
Nga vëndi rrotullonte.

Asgjë s'kuptoja ç'bënte plaku
Dhe isha bërë vrer,
Po ati im e futi dorën
Dhe ja, një maliher!...

— «Tani me mua eja bir,
Merr leckat, thuprën, vaj!...»
I mbloodha gjërat një nga një
Ashtu siç tha babaj.

Dhe hymë brenda në qilar
Ish koha për mësim:
— «Kështu ky fshihet, mbushet, shkrepet,
Shënohet, biri im!»



... Dhe qysh ahere e fillova
Mësimin ushtarak,
Po siç e dini, djalëria
Këtë e ka merak.

Pastaj me atin tim ne shtimë
Në shënjë në oborr.
Dhe fqinja jonë llafazane
Po shahej në sinor:

— «Demir, s'ke turp, je burrë plak,
Po eja pak ndër mënd»
Babaj i thoshte: « — bëjmë qitje,
Po mbaju, mos u trëmb!»

Po kur i thashë atit tim
Te kumbulla me fletë:
— «Përse dhe pushkën ma mësove,
Ç'do bëj me të në jetë?»

E thithi tymin e çibukut
Dhe tha të njëjtat fjalë:

— «Që mos ta hajë qeni shkopin.
O biri im, o djalë»

III.

Poemën time për babanë
Un' nuk e bëj të gjatë,
Se kushedi, o mik i dashur,
Kështu s'e do im atë.

Me tinguj, ngjyra dhe kurora
S'besoj që ta vesh fare,
Se frikë kam, e gris babaj
Dhe dredh me të cigare.

Poema ime, vënde-vënde,
Rastis që të vret veshin,
Po me poetin hë për hë
Kritikët le mos qeshin.

Poemën time, mik i dashur,
Ti ndiqe ku e lashë,
Këtu un' hapa parentezë
Dhe fjalë shumë thashë.

... Kish ardhur vjeshta atëherë
Me mjegull e me shi
Dhe s'kishte fletë gjelbëroshe
Në kopësht, në qershi. . .

Përroi rrëshqiste tatëpjetë
I murmë mos më keq



Dhe varnin kokën përmbi ujë
Te lumi shelgjet pleq.

Ahere vinim me babanë
Nga ara nëpër shi
Dhe ndiqnim udhën të menduar
E mbushur me mërzi.

Kasollja jonë ne na priste
E vogël, si këpurdhë,
Me një dritore me purteka
Që dukej përmbi udhë.

Ne hymë brenda që të dy.
Hostenë plaku la,
Pastaj m'i hodhi mua sytë
Dhe urt' e butë tha:

— «Gatitu bir, gatitu djalë,
Në mal ne do të shkojmë!»
Kujtova unë se do vinim
Për dru si gjithëmonë.


Por foli prapë ati im,
Me zë të ashpër pakë;
— «Do shkojmë pushkët t'i provojmë
Në male, nëpër flakë!»

Dhe e kuptova atin tim,
Opingat mbatha shpejtë,
— «Tani do shkojmë, lart në male,
O biri im, në çetë. . .»

IV

Edhe ne shkuam në një çetë:
Baba e djalë tok;
I vogël isha atëherë,
Po atin kisha shok.

Babaj më merrte në përrenjtë
Dhe tok me të qëllonim,
Pastaj ne ngriheshim të dy
Dhe prapë tok sulmonim.



Aq sa një ditë komisari
Tek neve u afrua,
Diçka i tha në vesh babajt,
Diçka i tha për mua.

Im atë qeshi me ngadalë
Dhe drodhi pak mustaqet,
Gëzimin pashë t'i vraponte
Tim eti nëpër faqet.

Një ditë fshehur në një ferrë
Fashisti pushkën ngriti
Dhe komisarin xheç e vrau;
Po ati im ja priti. . .

Një tjetër pushkën e drejtoi
Nga gjoksi i tim eti,
Po plumbi im në ball' e priti
Dhe ra në balt' e mbeti. . .

O! Trim me pallë është' im' atë.
Në vetull gjak të merr. . .
Një batalion nuk ka ç't'i bëjë
Kur shtje me maliher. . .

V.

. . . Kështu luftuam krah për krah
Me shokët partizanë,
Të dy ushtarë kemi qënë,
Të dy ne me babanë.

Të dy ne ishim në një çetë,
Pastaj në batalion,
Pastaj u hodhëm në brigadë,
Pastaj në divizion.

Të dy ne morëm nga dy plagë,
Të dy ne u shëruam,
Të dy u hodhëm nëpër flakë,
Tiranën e çliruam.

Dhe kur u ndanë dekoratat
Për trimat, në Tiranë,
S'do mënd që plakun edhe mua
Pa pjesë nuk na lanë

Po kur i thashë atit tim
Njëherë kur ra nata:
— «Përse për mua dhe për ty
Të njëjtat dekorata?»




Ai në gjoks e vuri dorën
Dhe foli me ngadalë:
— «Se nuk na hëngri qeni shkopin,
O biri im, o djalë!»

VI.

Dhe erdhëm përsëri në fshat
Dhe punën e filluam,
Shtëpin' e djegur bërë shkrumb,
Ne bashkë e ndërtuam.

Ish bujk' i zellshëm ati im,
Nuk dinte shi e mjegull,
lëroi e mbolli në selishte
E grur' e moll' e pjergull. . .

Reforma atit tim i dha
Dy ara tek një lumë



— «Do mbjellim grurë — thosh ai —
Do mbjellim grurë shumë»

I dha një ka balash të madh
Me brirë si hosten,
— «Të tillë ka — më thosh babaj —
Në botë nuk e gjen!»

Punonte dit', punonte natë
Dhe arat, plaku, çante,
Por prap ne kishim varfëri
Dhe vojtja prap na hante.

Un' atëherë nuk kuptoja
Dhe thosha: — «kushedi,
Gabim do ketë qeveria
Që ka kaq varfëri. . .»

Po sidoqoftë at' e bir,
S'i humbëm shpresat kurrë;
Vështirë qe, po jeta çelte
Në fush' e zall' e gurë.

VII.

Ish bujk' i zellshëm ati im,
S'e trëmbte shi e mjegull,
«Po nga pasardhësit e tij
Ai kërkonte rregull».



Dhe mua donte të më bënte
Të zellshëm siç ish vetë,
Më dha në dorë prap parmëndën,
Hostenë, të dy qetë. . .

Po un' i thashë një mëngjez
Te vatra i menduar:
— «Do hyj me shokët në gjimnaz,
Ësht' koha për t'u zgjuar!»

Ai ngadalë m'u përgjegj
Me vrer e pikëllim:
— «Po pse më le të vetmuar,
O djal', o biri im?»

Të njejtat fjalë përsërita
Që vetë m'i mësoi:
— «Që t'mos ma hajë qeni shkopin;
O atë, pa do shkoj. . .»


VIII.

... Un' isha larg nga ati im,
Se hyra në gjimnaz,
Po letra plaku më dërgonte
Nga fshati Menkulas.

Një ditë letër, shokë, mora:
«I dashur djali im,
Jam mir' e zotin lus për ty,
Të faltë plot gëzim;

Un' letrën s'po ta bëj litar,
Un' letrën s'po ta zgjat,
Veç po të them si venë punët,
O biri im, në fshat:

«Kolkosz» ne ngritëm (siç i thonë)
Ca deshin e ca s'deshin,
Për ne ca thoshin se u çmëndëm,
Me ne disa po qeshin...



Po ne e nisëm udhën tonë
Dhe bukur do të dalë. . .
Kështu dhe rusi e ka nisur,
O biri im, o djalë!»

E mbyllte letrën ati im:
«Ti eja, bir, në fshat,
Mundohu leje mos të japin,
Të paktën, për një natë».

IX

Një ditë, erdha nga gjimnazi
Në tokën prindërore,
Dhe, tok me atin, brodhëm — brodhëm
Ndër vreshta dhe bregore.

Pastaj u ulëm afër shelgut,
Nga xhepi letra nxora,
O miq', poemën q'e lexuat,
Në duar un' e mora.

Dhe ja lexova varg për varg
Tregimin tim të thjeshtë.
Ai dëgjonte dhe ngadal',
I lumtur, buzëqeshte.

Por nuk më tha se kushedi,
Un' jam poet i parë,
po tha: — «Kjo këngë, hë për hë,
Nuk është për të sharë.

Veç nga Naimi ti je larg
Si fshati me Tiranën! . . .»
Un' buzëqesha, kur dëgjova
Kritikun tim babanë. . .

Dhe kur më tha: — «Përse i shkruan
Çdo gjë që na ka ndodhur?»
— «Që mos ta hajë qeni shkopin» —
Tim eti i kam folur!



POEMA E UDHËS


Un' dolla...

Mbas meje dera u mbyll

Eduard Bagricki

I.


Në fshat më rrodhi mua fëminia
Në kohra të vështira me mjergull...
...E sjell ndër mënd, kur zgjatej te avllia
Dh' oborrin zinte tej e tej një pjergull.
E sjell ndër mënd dhe pusin shekullor,
Çikrikun me litar' e tij të vjetër,
Kapakun, që hapshim ne me zor,
Të mykur e të plasur krejt nga vjetët.
E sjell ndër mënd çatinë e shtëpisë,
Kur hipte ati im dhe pikat zinte...
E sjell ndër mënd direktët e çatisë,
Që thyheshin, kur borë shumë binte.
E sjell ndër mënd Baloshin, qenin tim,
Kur duart më lëpinte dhe më hidhej...
Po bukën ne e nxirrnim me mundim
Ndaj i pangopur herë-herë lidhej...
E sjell ndër mënd babanë, kur i lodhur
Nga puna vinte vonë me tu errur;



Opingat nxirrte vrejtur dhe pa folur,
Në vatër shtrinte këmbët për t'i terur.
E sjell ndër mënd kur grindej nënë hundë
Me nënën për «fasulet e paziera»,
Për «qumështin që ende s'e kish tundë»,
Për «bukën e papjekur»
E të tjera. . .
Nevrik ish ati im, nevrrik i madh,
Po skamja mbjell veç grindje në shtëpi,
Ashtu siç mbijnë gjëmbat në livadh,
Kur moti është' i that' e nuk bje shi.

II.

. . . Dhe mua asnjëri s'më përkëdheli,
Veç nëna herë-herë me mundim
Më ndiqte edhe loste te zabeli,
Kur dru kërkonte von' në perëndim.
Babaj nuk kishte nge të humbte kohën
Me mua duke bredhur cak më cak. . .



Nga puna, kur kthehej, ulte kokën
Dhe zhytej në mendime në oxhak.
Me qerka nuk më kolovitën kurrë
Dhe rruzuj nuk më blenë në pazar.
Mes pluhurit un' lojta veç me gurë,
Livadheve un' lojta nëpër bar.

E sjell ndër mënd, kur plakat në mëhallë,
I qaheshin tim eti veç për mua,
Se si u theva xhamet dhe në ballë
Një plakë e godita në katua!

I sjell ndër mënd dhe shokët një nga një,
Kur bridhnim me kopetë këmbëzbathur,
Kur losnim dhe kur çirnim për hiçgjë
Fytyrat, njeri-tjetrin duke kapur...

E sjell ndër mënd kur ulesha në plisa,
Nga këmba nxirrja gjëmbat me gjëlpërë.
Sikur të gjithë gjëmbat un' t'i mblidhja
Do bëja një vandak, besoj, të tërë...


III.

Nevojën un' e ndjeva që kur isha
I vogël sa një zoçkë — mituri,
Që kur nga dera çapëzat i nisa,
Që kur në këmbë shkova gjer n'avlli.
Që kur më dolën dhëmbët qumështorë
Mësova ç'do të thotë fjala «bukë»,
Q'ahere un' mësova sa i gjerë
Do ish ay që lypte n'atë udhë. . .
. . . Dhe rridhte fëmini' e turbulluar,
Dhe dukej se nuk ishte fëmini,
Po ish diçka m'e pjekur dhe m'e vuar,
Po ish diçka që quhet pjekuri. . .
Me krismën e dyfeqeve në male,
Me ngritjen e raketës ¹⁾ n'errësirë,
Me vrull e hymnit «Internacionale»
I thash' un' fëminisë lamtumirë.
Filloi rinia ime e furishme,
Si llava e valuar ndër vullkane,
Filloi rinia ime e furishme,
Filloi ajo në rrugën partizane.

IV.

. . . Në rrugë dolla.
Nata derdhte shkrumb,
Dërgonte erë me tufan Morava
Dhe gjurma s'kish dhe tokë s'kish gjëkund.
Veç, borë, natë, erë në Dumbravë.
Un' popullin e pashë,
Zgjodhi udhën.

1) raketa = shënja e alarmit



Që lart në mal, mes grykave, të çon,
Un' pashë, kur të dashurit u puthën
Dhe udhën morën që në gërxxh dredhon.
Po era fryn! . . .
Trazohet akulli me natën.
Dhe gjurma s'ka, por rrugën un' e di!
Ndër prralla kam dëgjuar se kur shpatën
E puth, kur udhën merr nëpër stuhi,
Ahere, zanat shtigjet t'i tregojnë;
— «Sa marrëzi!» — me veten time them —
Le zanat që në borë nuk jetojnë,
Por edhe dreqër s'gjen! . . .
. . . Dhe unë natën ec në rrugën time.
Nën këmbë bora krrak e krruk kërcet.
Nga er' e dimrit ndihen fishkëllime;
Lëpin borigat era në qamet.

V.

. . . Dhe ja u ngjita maleve të mprehtë,
Kur shkrepri drit' e kuqe mbi dëborë,
Mëngjezi kish përzënë gjithë retë

Mbi malet shekullorë. . .
 Në mal një burr' i gjatë si më priti
 Ahere kur në çetë e takova!
 Kutinë me cigare nuk ma qiti
 Dhe fjalë përmallimi nuk dëgjova.
 « — Në qoftë se me ne kërkon të vish,
 Jatakun ti këtu e ke të shtruar
 Në gjirin e vëllezërve të rrish
 Në shpellat e përrenjve të motuar!
 — Tregoni, djem, se ç'pasuri ne kemi,
 Tregoni shokut dhomat dhe oborret,
 Tregoni shokut shtretërit, ku flemë,
 Tregoni shokut zjarret nën dëborë. . . »
 Dhe shokët më treguan shpellën mbarë.
 Un' dhe një thes me bukë sjell ndër mënd,
 Që ndodhesh mes dy shkrepash dysh të çarë;
 S'e dij pse ngula syt' mu n'atë vënd! . . .
 . . . Kështu me çetën partizane shkova,
 Hero un' kushedi dhe nuk kam qënë,
 Po vëndin tim e mbrojta dhe e çmova
 Dhe mund, për të, dëshmor të kisha rënë!



VI.


S'mbaron rinia ime, ajo rrjedh
 Dhe rruga ime prap diku më thurret,
 Më thurret në gërxh, më thurret në bar' e gjeth,
 Më thurret në fushë, fshat, apo qytet. . .
 Prap n'udhë dal.
 Me vete torbën kam
 Dhe batanijen lidhur me kujdes.
 Ku jini, miq, un' prap me ju sot jam!
 O njerëzit e ndershëm,
 Mirmëngjez!
 U përshëndes, vëllezër, tungjatjeta!
 Pranomëni dhe mua në kazermë!
 Un' vij nga larg nga majat e përpjeta,
 Ku shkëmbin çpon e del me vrull një çezmë,
 Ku rron e ndershmja plakë, nëna ime,
 Në fshatin e rrethuar me lajthi.
 Më nisi n'udhë flokëbardha ime,
 Më vu në torbë bukë me turshi.



Edhe kur ika, qante me ngadalë:
— Ngaherë je, o bir, në udhëtim,
Po si s'të lodhi udha, more djalë?
Po si s'të lodhi udha, biri im?

VII.

... Dy radhë me krevate ka kazerma.
Në mes të njerës radhë — vëndi im.
Këtu pagurin kam me ujë çezme,
Atje kam torbën time me ushqim.
Jorgani im — një batani e vjetër,
Që plaku im pipinove ua mori,
Me të un' fjeta netëve në çetë,
Kur egërsonte erërat dhjetori.
Paguri im — pagur prej Gjermanie,
Peshqesh ma fali shoku komisar,
Kur buzë lumit afër një korie,
Banditëve barut u dham' e zjarr!






VIII.

Ngaherë mbrëmanet kazerma zjen,
Këndojmë «Hekurudhën e Rinisë».
Te trari i kazermës na shkëlqen
Kandili i vjetër dhe një copë pishë.
Të çjerrë copë-copë ndër rrëpira,
Si dreqër nxirë nga korriku — furrë. . .
Po ne këndojmë këngët më të mira,
Që malet rrotull nesh s'i ndjenë kurrë!

IX.

Punonim ne në balt' e shi, e diellë,
Në tym të verdhë, vapë apo erë. . .
Për ne ndonj' herë s'kishte as të diellë,
Prandaj ndokush mërzitej bëhej vrerë. . .
. . . Kështu një shok pështyu edhe lopatën,
E hodhi afër këmbëve të mia.


Vështroi përreth si rihte shiu baltën.
 — «Në djall të vejë!» — tha dhe shkau si hija
 Vështonim ne si ikte nëpër shi,
 Këmishëlagur shoku yn' i djeshëm,
 Dhe zhdukej nëpër ujë gjurm' e tij,
 Kur frynte er' e maleve t'atjeshëm.
 — «Eh, dezertor!» — i foli komandanti
 — «I poshtri!» — tha një tjetër që matanë.
 Un' grushtin, i mërzhitur, bëra gati,
 Por dezertori humbi ndër ormane!
 ... Ne kishim udhën ton', ai të tij,
 Ai u zhduk në balt' i vetëmuar,
 Ne baltën e qëronim nëpër shi
 Të gjithë tok, si miq të dashuruar.
 ... Pastaj atje zhavor e gurë shtruum,
 Binarë lisi vumë me kujdes,
 Mbi ta dy vija hekuri kaluan
 Që zgjateshin çdo mbrëmje, çdo mëngjez...





X

... Kazerma jonë vete çurkë natën!
Buçasin qiejtë dhe rufeja bje.
Ky shi, ky çrregullim e zgjoi brigadën,
Q'u lodh në balt', nga pun' e rëndë dje...
Jastëket, batanijet llom u bënë,
Bile në trup na hyri ujt' e ftohur.
Jelekun nënë kokë e kam vënë
Po dhe ai s'ka mbetur pa u njomur.
Kazerma zjen. Kush shahet, kush ankohet.
— «Fenerët ndizni!» — thurret dikush në shtrat.
Kurse diku një këngë po dëgjohet,
Ndonjë shejtan, siç duket, s'rri rehat.
... Ne kaq e patëm!
Akull-akull ngrimë,
Sikur mos ishte shoku guzhinjer:
— «Vëllezër, ejani me mua në guzhinë,
Se zjarri flakë — tha — atje po merr!» —



XI.

Ne vajza kishim plot, por vetëm një
I lojti mënj djelmoshat sa e panë!
Sa ëndra të çuditshme pam' për të,
Sa herë në mendime për të ramë!
Për mua s'kish më lodhje e mundim,
Për mua ish kazerma si pallat.
Ku rronte një princeshë si agim
Dhe unë isha princ me mall e fat.
Ajo s'më tha «të dua»; por më deshte,
Ajo s'më foli shumë, s'm'u betua. . .
Veçse e ndjeja kur më buzëqeshte
Se do të thoshte-fjalëzën «të dua»,
Të dy në mbrëmje dilnim jashtë shpesh,
Kur ngjyr' e purpurt derdhej përmbi male,
Kur tym' i kaltërt zbriste shesh më shesh
Dhe rrëkëllehej fushës me ngadale.
Filloi të hapej fjala në kazermë
Për ne të dy, për vashën «që shëtit!»

Po ku t'a din ata çdo thotë zëmër,
Çdo thotë zjarr që mua më zhurit! . . .
Një mbrëmje, ne të dy, pas bregut shkuam;
Ish nat' e hëna shkiste nëpër retë.
Dhe nuk e di se si u përçafuam,
Se si u puthëm aq e aq të nxehtë! . . .

XII.

E sollëm trenin.

Udhën ne e shtruam.

Sa keq, sa keq që s'erdhi nëna ime,

Të shihte se ç'punuam e ç'ndërtuam!

Të shihte kët' përbindësh me gulçimë,

Qe sollëm ne me djersën që kulluam.

. . . Dhe vërshëllen.

Mbi djersën tonë shket.

Dhe për të parën herë i hutuar

Un' hip atje, ku këng' e gaz buçet,

Me vashën që këtu kam dashuruar.



Nga mbrapa tym' i murmë vetëm mbetet.
Dhe rruga shkon në mal e në luginë,
Dhe përsëri ajo diku më thret,
Dhe përsëri un' torbën kam mbi shpinë. . .
. . . Kjo udh' i ngjet poemës pambarim,
Ajo s'ka fund,
Ajo vrapon, vrapon. . .
Dhe tok me të vazhdon tregimi im,
Vazhdon,
Vazhdon! . . .



TRYEZA E LËNDEË

Faqe

Poemë për babanë dhe për vete	3
Poema e udhës	17

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIRKASTET

32200

Redaktor: Halil Qendro
Korektore letrare: Adelina Mamaqi
Piktor: Hiqmet Agolli
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi: 4000 Kopje Format 78X109/32 Stash: 2204-55

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë